

MUZEU ETNOGRAFIK I MALËSISË, “MALËSIA” E DËSHMIVE 3000 VJEÇARE E RRËNJËVE ILIRO-SHQIPTARE

Ndue BACAJ

Publicist, Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Muzeu Etnografik i Malësisë, “Malësia” e dëshmimeve 3000 vjeçare e rrënjëve Iliro-Shqiptare, përpiqem të prezantoj muzeun me inventarin arkeologjik dhe etnografik, së bashku me risitë e autoktonisë të trojeve shqiptare të Malësisë së Madhe e më gjërë. Ky muze me “inventarin” e tij përmban një histori të pakontestueshme etnike shqiptare, si me trashigimin e vjetërsinë e ekspozitave arkeologjike e etnografike, dhe me risitë që trashigon gjuha iliro-shqiptare e “inventarit” të muzeut. Kjo ka një rëndësi të madhe historike veçanërisht për autoktoninë e trojeve tona të okupuara ndër mote e shekuj nga Mali i Zi, ku autoktonia gjithnjë është e rrezikuar. Referati ka si qëllim njohjen e risive që përmban Muzeu Etnografik i Malësisë, si një vepër monumentale autoktonie. Me ekspozitat arkeologjike dhe “inventarin” etnografik që ka brenda, muzeu krijon një risi që përshkon një rrugë historike me rrënjë Iliro-Shqiptare të trojeve tona etnike, (edhe pse ku është ndërtuar muzeu këto troje kanë mbetur padrejtësisht nën shtetin e Malit të Zi). Referati në përgjithësi është një përmbledhje e monografisë të shkruar nga unë (Ndue Bacaj) në vitin 2021, që i kushtohet këtij muzeu dhe pronarit të saj z. Shtjefen Ivezaj. Në referat përpiqem të analizoj shkurtimisht disa nga ekspozitat dhe “inventarin” etnografik të muzeut, që u perkasin periudhave të ndryshme historike, qindra e mijëra-vjeçare, të banorëve autokton Iliro-Shqiptar të këtyre trojeve.

Fjalëkyçe: Muze etnografik, histori autoktonie, ekspozite arkeologjike, “inventar” etnografik, Çakçir, xhamadan, xhubleta.

ABSTRACT

Ethnographic Museum of Malësia, "Malësia" of 3000 years of evidence of Illyrian-Albanian roots. The paper aims to recognize the innovations contained in the Ethnographic Museum of Malësia, as a monumental work of autochthony. With the archeological exhibits and the ethnographic "inventory" inside, the museum creates an innovation that crosses a historical road with Illyrian-Albanian roots of our ethnic lands, (although where the museum was built these lands have remained unjustly under the state of Montenegro). The paper is generally a summary of the monograph written by me (Ndue Bacaj) in 2021, dedicated to this museum and its owner Mr. Shtjefen Ivezaj. In the papers we tried to briefly analyze some of the exhibits and the ethnographic "inventory" of the museum, which belong to different historical periods, hundreds of thousands of years, of the indigenous Illyrian-Albanian inhabitants of these lands.

Keywords: Ethnographic museum, autochthonous history, archeological exhibits, ethnographic "inventory", household furniture, men's clothing (Çakçir, glass), women's clothing (Xhubleta).

HYRJE

Me datën 01 maj 2002 në trojet etnike shqiptare të Malësisë së Madhe (Lekaj Tuz, Mali i Zi), fotografi profesionist Shtjefen Ivezaj me ndihmen e bashkeshortës së tij, Gjyste Ivezaj do t’ a kthenin shtëpinë e tyre në muze, në atë kohë shumëkush shprehu habi për këtë sakrificë, shumëkush i uroi dhe ndihmoi, por kishte edhe nga ata që këtë punë e sakrificë e quanin një ëndërr që do të shuhej shpejt e deri një ide të “çmendur” të këtij burri, atëherë rreth 65 vjeçar. Mirpo idetë e medha të shoqëruara me punë të mëdha atdhetarie duket se i ndihmon edhe vetë Zoti. Muzeu Etnografik sot është pasurua mjetueshëm për të qënë një vepër

monument autoktonie që pershkruan e mbartë jo vetem një rrugë historike, por me eksponatet arkeologjike dhe etnografike nderton një “autostradë” autentike; të drejtë, pa rrugica e pa kthesa, që të çon vetem në zemren e Europës antike e moderne. Mrekullia e këtij muzeu tashmë i ka kaluar kufijet lokal e ata kombëtare ai nuk është më vetem pronë e Malesisë së Madhe (të dy anëve të kufirit politik), dhe e patriotëve fisnik që e krijuan Shtjefen Ivezaj me bashkeshorten tij Gjyste Ivezaj, por është pronë e pa kontestueshme e historisë të autoktonisë rreth tremijë-vjeçare të këtyre trojeve Pellazgo-Ilirro-Arbënore-Shqiptare.

MUZEU ME RISI HISTORIKE SIKUR TË ISHTE 3000 VJEÇ

At Shtjefen Gjeçovi rreth një shekull më parë do të shkruante: “Visari jonë, historia jonë gjinden të mbulueme nën DHE, se mbi këtë visar mbeshtetet jeta e kombit. Një komb që s’ka histori të veten konsiderohet i vdekur. Që ketej shtrohet detyra e zbulimit e të studimit të kesaj historie nga vetë shqiptaret. Sa rrënime faltoresh të vjetra janë dermuar prej të huejve, sa vorre, suka e qytete janë çilë e shkatërruar, që sot s’u duket ma fije, sa tumula 3000-4000 vjeçare janë rrafshue, sa rrasa, shtylla, kapitoj etjer, që kanë ndejë në gjum të ambel e sot si gjenë ma aty. Të njëjti kah Shkodra, kah Kopliku e Vuksanlekajt e do të shohim prej gropash sa visare janë nxjerrë e bajtë prej të huejt.” Studiues francez që ka qenë edhe konsull në Shkoder – (Hyacinthe Hecquard) në studimet e tij theksonte se: “Kur turqit pushtuan Shqipërinë e Eperme në fushë gjendeshin Fshatra, Kisha dhe Keshtjella të cilave u ka mbetur vetem nami”.

Ndersa Shtjefen Ivezaj me eksponatet e muzeut i ka kthyer edhe nishanin historisë së autoktonisë të këtyre trojeve Ilirro-Shqiptare. Eksponatet e muzeut na zgjojnë kujtesen edhe për madhësinë e qytetërimeve që kanë “lulëzuar” në qytete, qyteza apo qytetet -kshtjella të Diokles, Medunit, Tivarit, Budves, Ulqinit, Vranines, Klementianes, Dinoshes, Qytezes Hotit, Marshenjtit, Ballezes, Potgorës, Shkodres, Drishtit etjer.. Për keto qytetërime, ndertime e zhvillime të hershme e të mrekullueshme që kishte arritur të ndërtoi ilirro-shqiptari, por të rrënuara më vonë ndër shekuj , profesori dhe studiuesi Giuseppe Gelcich (Xhuzepë Xhelçik), në vitin 1898 do të shkruante: “I zgjuar nga natyra dhe i paisur me një shije të jashtzakonshme, Shqiptari i kishte stolitur qytetet e veta me monumente artistike shumë të çmuara, të cilat u zevendësuan pa shenjë e pa dukë nga kulla ciklopike zëzane dhe nga ledhet mbrojtëse venedikase . Shtodhe goditjen e pa mëshirë që i shkaktuan shpatat dhe zjarret perpirëse, që i shpartalluan ato qytete fatëkeqija. Kështu heshtën përgjithmonë sa e sa punishte, që e kishin bërë zakon të dergonin në vendet e Ballkanit, në të dyja brigjet e Adriatikut e deri në Maqedoninë e largët punime fort të hijshme në argjend, në fildish, në koral, në sedef, si dhe lesh e armë të atilla që konkuronin edhe ato të Damaskut, krahas këtyre prodhonin edhe orendi prej bakri shumë të sterholluara nga çdo anë. Qendismat me fije ari, me të cilat deri në atë kohë pelqenin të stoliseshin të mëdhenjtë e vendit dhe gratë më të bukura të Ballkanit, e kishin prejardhjen kurdoherë nga Shqipëria. ”Nderkohë trojet tona kanë qenë të banuara mijera vite më përpara, që në kohrat primitive, ku me këtë rast po “dallojmë” trojet e Grudes, nga Dinoshë në Selishtë, në Kelmend e më gjërë ku gjenden shpella që dëshmojnë se janë përdorur për banim qysh në parahistorinë e mugët.

EKSPONATET E MUZEUT

Eksponatet arkeologjike, por edhe etnografike të këtij muzeu nuk janë të veçuara nga krahina e qytetërime të “tjera” Ilirro-Shqiptare, ato kanë të njëjten kulturë e të njëjtin zhvillim. Këtë e tregojnë eksponatet e gjetura të kohëve të hershëm, të mesëm e të vonë, figurat prej balte, enët një dhe dy vegjake (vorba apo qypa) prej balte dhe prej qeramike, pa pikturim dhe me pikturim të shek.VII-VIII mbas Krishtit, fibulat e bronzit, varset e bronzit, unazat, vathët, bylyzykët, terrakotat, sëpatat, figurat (prej balte) antropomorfe, shpatat, thikat e bronzit eksponate të ndryshme hekuri, bakri, bronzi etj. Të gjitha këto eksponate janë të njëjta me

ato të gjetura në trojet e tjera etnike Iliro-Shqiptare, duke përfshirë edhe ato troje që sot janë jashtë kufijëve politik të Shqipërisë e Kosovës.

“INVENTARI” ARKEOLOGJIK E ETNOGRAFIK I MUZEUT

Eksponatet arkeologjike të gjetura nëpër trojet e Malesisë e Shqipërisë (të ekspozuara në muze) tregojnë edhe “kulturë” të njëllojtë me ato të Europës si: Sakica e hekurit, Fibula e bronzit, unazat, lloje vathësh etj, që janë të ekspozuara edhe në muzeun Britanik, në muzeun e Athinës dhe në muzeun Gjerman, etj, ku zbukurimet mbajnë skema peshkimi, gjahu, zogjesh, figura njerzish, luftëtarësh dhe vizatime gjeometrike. Eksponatet arkeologjike dhe etnografike Iliro-Shqiptare kanë qënë të vlersuara prej kohësh edhe nderkombetarisht. Për këtë po “kthehemi” në vitin 1925, kur në ekspoziten misionare të Vatikanit në Romë, Shqipëria bënte një figurë të mirë, me praninë e veshjeve të saj karakteristike (kombetare të veriut N.B), të armëve të lashta, dhe të objekteve të tjera të bukura të karakterit etnografik. Në vitrinë ishte ekspozuar e vlersuar edhe materiali arkeologjik. Delegati i Gjermanisë në ekspoziten e Romës duke parë këtë koleksion tha: “Me keto vjetërsina Gjermania mund të paguaj një kest të madh të borxheve të luftës (luftës parë botrore).

Megjithatë Shtjefen Gjeçovi mbeti i varfer. (Siç ka mbetur edhe Shtjefen Ivezaj i muzeut etnografik të Malesisë). Vlen të shënohet se më përpara, në vitin 1905 Shtjefen Gjeçovi i kishte treguar arkeologut gjerman dr. Paal Traeger disa objekte të gjetura në një varr në Kodër-Bogëz (Laç-Kurbin), në mes të cilave edhe një unazë të vjetër me mbishkrim, ku Gjeçovi i kerkoi ta ndihmoi për ta identifikuar, arkeologu gjerman nuk i tregoi gjë, por ja vlersoi 7 napolana flori, Gjeçovi me një perbuzje ju pergjigj: “ Me mi dhanë 400 napolona nuk e shes, por veç deshta me ditë kohen dhe çmimin e vjetërsisë”. E cilësova këtë “episod” se dhe krijuesi e themeluesi i muzeut etnografik të Malesisë z.Shtjefen Ivezaj ka pasur oferta për ti shitur eksponatet e muzeut, por ai nuk ka pranuar kurr t’i shesë këto vlera kulturore-historike të Malësisë e Shqiptarisë.

Eksponatet e muzeut janë të vjetra sa historia e tyre, por ka edhe të “prodhuara” në periudha më të vonshme, por edhe keto eksponate ruajnë me besnikri trashigiminë historike dhe kulturore, që të parët tanë autokton i trashiguan këto vlera jetësore e zhvillimore nga njeri brez në tjetrin, duke ruajtur edhe emertimet gjuhësore Iliro-Shqiptare. Duke vrojtuar me kujdes shumë eksponate të këtij muzeu, të shkon mendja te fiset ilire, Labeatet e Diokleatet që popullonin trojet e Malesisë Madhe Etnike e më gjërë, të cilët kishin mësuar që nga fundi i mijëvjeçarit dytë para Krishtit, se si të nxirrnin hekurin nga minerali ..që deri në shekullin e IX (para Krishtit) ky metal i rrallë perdorej kryesisht për zbukurime. Ndërsa pas këtij shekulli filloi të bëhëj metal i zakonshëm për vegla pune, orendi shtëpiake dhe armë.

DISA NGA ALMISËT APO ORENDITË SHTËPIAKE NË MUZE

Në Muzeun Etnografik të Malësisë janë të sistemuara eksponate të ndryshme prej balte, druri, qeramike, hekuri, bakri apo remi siç i kanë thënë malësorët. Aty ka të ekspozuara edhe prerje të hershme monedhash, por edhe copa tjegullash apo tullash Ilirike e Italike. Muzeu është i pasuruar me enët dhe almisët shtëpiake si: sofren, sininë, tepsinë, magjen, qethin, lugët, lugjet, luginën, fulteren, kusiat, soxhakun, kakinin, vargonjtë, mashën, sahanin, bulieren, tejen, duaqit, kotrovën, qypin, babunen, vegshin, vozgën, damixhanin, enët një e dyvegjake, kryporen, tpinin, sheken, mokren, xhezen, filxhanat, kupen, thiken, grihen, limen, gershanët, gjylpanën, postin, trupicën, stolin, shilten etj. Për bulierën me të cilën transportohej e ruhej uji, që malësorët e vlersonin si simbol të jetës duke thënë, “Uji është jeta, ku ka ujë ka jetë etj”. Por me këtë enë uji shpesh kanë lidhje edhe pak “sherre”, e shumë dashuri në mes vajzave e djemve, pikrisht kësaj i “kendon” edhe i madhi i letrave shqipe Martin Camaj me vargjet: “Zade moj Zade,

si nuk pëlças, sa uji bjen në bulier, çoje ruben e nepëm ujë me tas, Zade moj vashë. Buza mua shqim ma terë .” Ndersa vlen të kujtohet se sofrat është pararendësja e tavolines së sotme, që është perdorur nga të parët tanë si orendi shtëpiake shumë e rendësishme, rreth të ciles uleshin burrat, paria, gratë, femijet, por edhe miqtë e të ftuarit e tjerë. Sofrat kishin edhe misionet e emertime të ndryshme si: “Sofra e bajrakut (flamurit), sofrat e fejesës, sofrat e dasmes, sofrat e udhës së mbarë bijës, sofrat e mirseardhjes nuses, sofrat e drekëve, sofrat e pajtimit, sofrat e puntorisë, sofrat për mikun, sofrat e përgimit, sofrat e ndrikullave, sofrat për nunin, sofrat e probatinisë, gostia e thiut”. Burrat rreth sofres uleshin këmbëkryq, ndersa gartë rrinin ndër stola. Pranë sofres duhet ndejur brijaza, duke ndenjor nga sofrat vetëm njerin gju, për të mos marrë vend shumë. Për të treguar sa miq kishte shtëpia, perdorej njësia e matjes – sofër, të cilës i qasen 11 vetë për të ngrënë në të. Risia sinjifikative e kësaj orendie shtëpiake Iliro-Shqiptare është se u ka qëndruar shekujve dhe është “simboli” i formës saj të rrumbullakët. Edhe sot kur zhvillohen bisedime që kërkojnë “vlersim të barabart” partnerësh dhe homologësh perdoret ” e bija” e sofres, tavolina e rrumbullakët.

Djepi me foshnjen në të është njohur edhe si “mjet” i vlefshëm

Në muze qëndron hieshëm edhe *djepi* ku u përkundën me këngët e zemrës së nënës për atdhedashuri, kreshniket e këtyre trojeve e maleve që nuk e lanë kurrë Shqiperinë-nanë pa djal në votër. Këngët e Djepit (ninullat) që këndonin nënat shqiptare janë të shumta, e me karakter, trimërie, fisnikërie, bukurie, dashnie, besnikërie e mbi të gjitha atdhëtarie. Djepi me foshnjen në të është njohur edhe si “mjet” i vlefshëm, që “ndalonte” pushkën e pajtonte gjaqe në mes shtëpiave e familjeve. Për këtë fetari, atdhëtarit dhe filozofit i njohur at Anton Harapi do të shkruante: “Kur ishin punët e pezmatueme dhe s’punonte hatri as fjala e kujtë, na gjithmonë kemi marrë një foshnje në djep, kemi zgjidhë burrat ma të mirët, kur kemi mujtë kemi marrë me veti edhe klerikë, edhe i kemi shkue të zot të shtëpisë n’derë të oborrit, për me na falë e dhanë besë për hatër të Zotit e të asaj foshnje. Aty në derë pa hij mbrendë kemi permbysë djepin me gjithë foshnje, e kemi pritë të dalë i zoti i shtëpisë me na ndeshë e me na sjellë mbarë atë djep pastaj na ka shti mbrendë dhe na ka dhanë besë si e lypte nevoja. Por kur i zoti i shtëpisë nuk ka dalë me i ndeshë njerzit që i kanë në derë, e as se ka prekë djepin, atëherë asht marrë vesht se nuk don me dhanë besë, e na pa i hij mbrendë aspak, jemi nisë e shkua ndër shtëpijat tona. Zotni me i çue kujë djepin në derë asht ma e mbramja e ma e fuqishmja mënyrë për me ndërmjatsue”. Në këtë muze të bien në sy edhe “almiset”, me të cilat punonin gratë e shtëpisë së malësorit shqiptar si shtroje, mbloje e veshje prej leshi si vekët, gerhanët, furka me bosht e tjerë. Shpesh herë kur lindesh vajzë thoshin ka “lindur” furkë, ndersa kur lindesh djalë thuhej ka lindur “pushkë”. Për furkën ka edhe një histori të “vogël” që mendova ta citoj: “Nën emër furkë përmbliidhen, të thuash, të gjitha rangët e detyrat e grues në familje. Furka asht ‘almistra’ që e perdorin granija për me tjerë me të. Perdorimi i furkes kapet deri në ma të hershmet mote të historisë”. Në muze i është bërë vend edhe gurit të gjakut e të tjerë (si mjekim popullor). Por, në muze shihet edhe një derë e vjetër me moshë mbi 170 vjeçare, e cila i përket shtëpisë të Smajl Martinit të Grudes dhe bijës tij Tringës, e cila hapi edhe shkollë në Grudë, duke sakrifikuar pasurinë e saj.

EKSPONATET E MUZEUT TRASHIGOJNË EDHE GJUHËN ILIRO-SHQIPTARE

Eksponatet arkeologjike të muzeut ruajnë një histori të “heshtur” të punës e jetës së këtyre trojeve, kryesisht me karakter bujqësor. Në muze kemi almise që përgatiste vetë bujku dhe ishin të “konsumueshme” si parmenda, shtjeza, trina, grada, koshi, koshiqi, kosherja e bletve, krozha, rrota e qerres, kulari, zgjedha, qaforja, hosteni, kamxhiku etj. Por mbi të gjitha në muze janë të ekspozuara almise apo vegla bujqësore të cilat trashigojnë edhe emra në gjuhën Iliro-shqiptare, disa nga të cilat perdoren edhe sot si: Kazma, Shati, Kmesa, Kiza, Kosa, Kosorja, Sëpata, Latusha, Lopata, Drapëri, Parmenda e Plori me paimetë tjera për pënden e qeve e për kalin. Por keto vegla bujqësore na kujtojnë edhe bimët që kultivonin

të parët tanë dhe ruajnë edhe sot emra të trashiguar nga ilirishtja si; Gruri, Elbi, Thekra, Tershana, Meli, Qiqra, Fasulja, Batha, Lakra, Pjepni, Preshi etj. Nga ilirishtja trashëgojmë edhe emrat e disa pemve frutore si Kumbull, Qersh, Pjeshkë, Fik, pjergull, etj. Gjithashtu nga ilirishtja e kanë prejardhjen fjalët kalli, kallëz, plis, bluaj, hedh, mbjell, shijë, byk, kashtë, etj.

Duke parë këtë trashigimi të këtyre fjalëve dhe emrave iliro-shqiptare që kanë “rrugëtuar” prej qindra e mijëra vitesh të patrandura nga stuhitë e mungëtirat e shekujve na duket se tingëllojnë aktuale edhe fjalët:

“Shqiptar vëlla duaje gjuhën tande me një dashni të përflakëshme, jeto për të e vdis për të e mos t’na dhimbset jeta për dashni të gjuhës sa të kesh gjuhen ke me kenë edhe ti vetë”.

Me këto të dhëna arkeologjike perputhen edhe vargjet e Klaudianit, poetit që i perket fundit shekullit IV dhe fillimit të shek. V. kur ai shkruante: “Ai (bujku ilir) i pertrinë me grihen e tij kosat e nxira nga ndryshku, i bën të shkelqejnë shetrit e demtuar nga mosperdorimi, dhe e mrekullon parmenda, të cilin rishats në dorë e mori, plisa dheu dhe aromë mbjellje nxjerr. E ndërsa pret pyje e shkurre, këtë tokë të re, e kthen në ara e vreshta”. Duke parë me imtësi edhe disa paisje e mjete që u kanë sherbyer para-ardhësve tanë si bujqë, nuk duhet të harrojmë se Ilirët pershkruhen si mjeshtra të kultivimit të vreshtave dhe krijues të llojeve të zgjedhura. Ilirët kanë punuar si mjeshtra deri në GALI (Franca e sotme). Në shekullin e parë mbas Krishtit lavdërohej për prodhim vere një lloj rrushi ilir me emrin “BALISKU”. Madje, Plini i vjetri i krahasonte cilesitë e rrushit “Balisku” me coccolobis-in në Spanjë. Në viset Ilire prodhohej me shumicë elbi, nga i cili nxirrej një pije me emrin SABAJEN, pije e cila ka qenë e përhapur dhe është përdorur deri në mesjetë.

ARMËT E MUZEUT

Në muze shikon disa nga armët mbajtur nga malësori shqiptar ndër mote e shekuj, si taganin, kurtjelen, shpaten, harbinë, hutën, peticën, mauzerren, livoren, gjerdanin e fishekeve, veglat e pastrimit e vojimit të armëve etj. Armët kanë qenë të shumëllojshme, ato kanë ardhur duke u përmirësuar. Studiuesi dhe etnografi At Kolë Berishaj i ka renditur këto armë edhe sipas një dëshmie të marrë nga një plak 115 vjeçar nga Arza e Traboinit (Ucë Tomë Gjellaj). Ai armët e zjarrit i rendiste: Huta e zakonshme apo huta kacaturre – Kapsulaça – Huta Martine – Kapaklija – Berdanka - Ostrogusha - Novica. Pos këtyre ka pasur edhe armë të tjera që malësorët shqiptarë i “thërrisnin” me emrat: Xheverdare – Karajfile – Ltine – Breshane – Novicë – Dodume.

Armët shqiptari i ka mbajtur për mbrojtjen e vet, për mbrojtjen e vendit, si dhe për stoli e për plotësimin e trupit të vet. Në mentalitetin e vet, burri shqiptar ka qenë i hijshëm duke shkuar me armë, sidomos kur janë mbledhur në kuvend. Kudo e kurdo të shkosh pa armë i është dukur vetja si i çuditshëm, si i ngathët e si me pas diçka mangut. Shqiptari pra s’ka mundur të rrijë pa armë. Armët të shumtën e herës i ka marrë në luftë, por kur s’ka mundur ndryshe ka shitur kaun e kularit dhe e ka blerë pushkën dhe pa të nuk ka ndenjur. Pushkën e ka mbajtur “nuse” të pastër, të dliret si pasqyrë. Për armë edhe janë betuar (kanë bërë be). Kur burri shqiptar ka thënë: “Pasha armët”, shqiptari as të ka mashtruar as të ka ngrënë fjalët. Për armët edhe janë lavdëruar. Ndërsa një studiues i huaj i fundit të shekullit XIX për “dashurinë” e shqiptarëve për armët do të shkruante:

“Dorezat e revoleve që shqiptari mban në brez, janë të gjitha të gdhendura dhe të zbukuruara, por po i pëlqeu më shumë pushka, ajo është e gjatë, e hollë dhe njësoj e gdhendur dhe e zbukuruar, shpesh me gurë të çmuar, me një gdhendje të artë për gjatë tytës.”

Siç tregon historia jonë, armët kanë qenë “shokët besnik” të pandarë të malësorve e shqiptarëve ndër mote e shekuj, shpesh edhe në kushte mbijetese. Duke parë se shqiptari dhe arma e tij kanë qenë gati “sinonim” i njeri tjetrit më shkon mendja te vargjet lapidare të homerit shqiptare (At Gjergj Fishtës):

“Kemi këndue po armët besnike. Që flakërue kanë në dorë t’Shqiptarve. Kah kanë dekë për besë jetike. Kah kanë dekë kta, per DHE t’parëve” 19.

Mrekullisht e përshkruajnë jetën dhe perpjekjet e të parëve tanë vargjet “bashkohëse” me trojen shqiptare të shekullit XIX, Vraninen me titull: ”Shqiptari” nga të cilat “zgjodha” tre vargje të citoj: “Çfarë ka ma të shtrenjtë e ban fli për çdo gur Shqipërie. Është përmendore, madhështore në vorfenin e vet, po e preke ku i dhemb, në komb e në nder, të pret e të vret.

VESHJET E GRAVE E BURRAVE NË MUZE

Në ambientet e muzeut janë të ekspozuar veshjet kryesore të malësorve e malësorëve me në krye xhubleten. Ka mbetur unik krahasimi që i bënë xhubletes studiuesi hungarez Daniel Kornidez në vitet 1753-1754 kur shkruante: “As palloi, e as ylberi nuk kanë aq ngjyra sa xhubleta e grave kelmendase.” *Xhubleta në muze* na kujton se kjo ishte veshje unike, e bukur e fisnike e femrave iliro-shqiptare. Në xhubletë, edhe sot “bashkëjetojnë”: trashëgimia, historia, e pse jo edhe nostalgjia. Xhubleta në “luftë” me “harresen”, ndër shekuj gjeti “çerdhen” e mbijetesës mijëra-vjeçare, në veriun e Shqipërisë në pergjithësi dhe në Malësinë e Madhe në veçanti. Te malësorët u ruajt më gjatë e më mirë se në asnjë trevë tjetër iliro-shqiptare kjo veshje, dhe trashëgimia e saj të pakten rreth katërmijë-vjeçare. U ruajt nga stërgjyshët, gjyshet e nënat tona nga njeri brez në tjetrin. Xhubleta u ruajt jo vetëm si veshje me vlera të papërsëritshme të traditës popullore shumëshekullore, por edhe si veshje në të cilën “shkruhej” histori jete, zhvillimi, civilizimi, bestytish, besimesh etj. Nëse historia e popujve të tjerë të lashtë u trashëgua duke u shkruar në “hiroglife” të gdhëndura në gurë e mjete të tjera “rrethanore”, te iliro-shqiptarët kjo histori u trashëgua edhe e “qendisur” në mesazhet, ngjyrat, simbolet e figurat e xhubletës. Xhubleta ka qënë edhe objekt i shumë studiuesve dhe albanologeve, që nga Hoernes, Wide, Evans, Vasitis, Nopça e të tjerë, por ne po shkepusim pak rrjeshta nga ajo çfarë shkruan ilirologu i njohur kroat Aleksander Stipčević:

Gratë Ilire visheshin me xhubleten që mbajnë hyjneshat lokale dhe gratë valltare. Hyjneshat Diana vishej me këtë veshje në formë këmbane të qendisur mrekullisht prej qindra figurash e bojnash.

E kjo veshje grashë (xhubleta) është ruajtur mrekullisht te shqiptaret e Shqipërisë së Veriut. Përveç xhubletes në muze janë të ekspozuara edhe veshje të tjera si xhoka, postava, rubat (shamiat) e kokes të grave që janë trashigimi Ilire, madje edhe shamiat e bardha që shpesh lidheshin si kapica mbi kokë, janë trashigimi ilire, që kishin për qellim të ruanin floket nga pluhurat, por edhe të mos fshihnin hiret e fëtyrës së grave Ilire. Gjithashtu në muze gjinden edhe “paimë nusesh” si duvaku, masha me vargje, çorape, gubere, pshtjellakë, opakë me vaq, perqagëzat (nxirreshin prej lëkurës dhive e perdridhen sikur të ishin pej prej boshtit), këputët, krozha e nuses, si dhe arka ku futeshin teshat e nuses. Arka me teshat e nuses sterpikeshin me ujë të bekuem. Kur arken e nuses e çonin në shtepinë e djalit (që martohej) e prisnin me këngë e gëzim, si:

Po shëndritë rruga mbarë / po na vjen arka me pajë / eja nuse ardhsh e bardhë / ardhsh me baft e me nafakë / na e paç jetën e gjatë / ty të gëzoftë djali n’konak.

Gjithashtu në muze janë të ekspozuara stoli si: varse, vargj, vathë, unaza e ornamente të tjera zbukurimi për gratë.

Në muze një vend të rëndësishëm zënë **veshjet e burrave** që etnografi malësor At Kolë Berishaj i “shënon” me fjalët, petkat që ka bajtë burri, duke i renditur: Gjurdi – Gubere – Xhabadan – Mitan – Jelek - Kmishë – Sahat e qastek – Brez – Xhakçir (tirqit) – Këputë – Opakë (me vaq me saftjan me krygjëza e gogisht) – Qeleshe (kapticë plisit) – Shalli (shtatë pash) – Padifoga me duhan – Të dhezmet (gur unur e kaf) – Kamishi (çibuku sipësinë)”.

Nga veshjet e burrave menduam të “veçojmë” disa nga keto si: këmishën e burrave me origjinë ilire të qepur me dorë nga gratë, për të cilën një famulltar – etnograf e historian (*Lovro Mihaçeviq*), ka mbledhur një këngë vaji të gruas për burrin, që i kishte qepur e qendisur një këmishë, por që nuk kishte arritur ta gëzojë, ku në mes të tjerave i thoshte:

Njikët këmishë ti me m'ia çue / Edhe thuej ti Gjonit tem, Ruaje mirë o more trim, / Me flokë t'kresë e kam qendisë / Me lotë t'mi e kam ujtisë, / Me lotë t'syve e kam shpërla, / Në zjarm t'zemres e kam tha”.

Në shënimet e një udhëtari e studiuesi (të huej) në Ballkan e në Shqipërinë e fundit të shekullit XIX (nën pushtimin osman) do të gjejmë të shkruar: *Populli që të bie më shumë në sy janë Shqiptarët. Burrat janë shtatlatë dhe zeshkan, me tipare të pashme dhe të rregullta. Shqiptari më la pershtypjen e një sqimtarit. Ai dëshiron që xhamadani i tij të jenë i qendisur me serm e flori. Me vlera të rëndësishme autoktonie është trashigimia dhe hershemria e kapticës apo qeleshes së bardhë të burrave, e cila sipas studiuesve e historianëve është trashigimi autentike e asaj që mbanin para-ardhësit tanë ilirët.*

VEGLAT MUZIKORE

Një vend të rëndësishëm në Muze zënë veglat muzikore si lahuta, fyelli, zymarja, çiftelia etjerë, me të cilat të parët tonë i kantuan bukurisë, trimërisë e trojeve shqiptare. Këto vegla muzikore popullore shoqëruan, “prodhuan”, zburkuan, hijeshuan dhe i rriten vlerat folklorit autentik malësor e shqiptar, për të cilin at Gjergj Fishta do të thoshte: “Folklori asht pasqyra e kthejlltë e psihes së kombit, asht rrasa e mermerit me të cilën historija zgavron t’endunit e të shndritunit e popujve, asht cehja e pashterrshme e gjuhsisë e letersisë kombtare. Folklorin do ta shqyrtosh po deshe me shkrua historinë e kombit. Për veglat muzikore të të parëve tanë ilir, shkruan edhe gjeografi e historian i njohur Straboni (i cila ka jetuar rreth vitit 63 para krishtit deri në vitin 20 mbas Krishtit), nga i cili citojmë:

Ilirët- Dardanët muzikën nuk e lënë menjëanë, po përkundrazi përdorin gjithmonë fyj e vegla me kordha.

Ndërsa një studiues dhe etnograf shqiptar e përshkruan mrekullisht rëndësinë e këtyre instrumenteve folklorike, kur shkruan: “Malësori kur mërzhitet kap lahutën, fyellin, zymaren e tjerë dhe i bie duke e percjell me këngë të përmallshme. Këndon ditën në majë të ndonjë krepit, ose në hije të ahit. I bahet se dielli ka ngel kah e ndie, se zogjët janë grumbullua rreth tij si të marrun mendësh, se krojet e gurrat kanë ndalue e nuk qesin ujë për mos me ba zhurmë se shkëmbinjtë kanë ngreh kryet prej habijet, ndërsa hëna dhe yjet e natës i duket se e degjojnë me kënaqësi”. Lahuta veçmas si vegël muzikore popullore e traditës, ka qenë “shoqëruese” e malësorve në raste gëzime edhe në raste luftrash. Një gjë të tillë e cilëson edhe Kral Nikolla (i Malit të Zi) në poemën e tij “Kryengritja e Malsorvet - Malisorski Ustanak të vitit 1911, nga e cila citoj:

“Kelmendasit luftojnë rreptë / Gjysa e këtij bajraku kanë lahutat mbas shpine / Për me këndue gjatë luftimit / Lumnit e veta të fitimit.

EKSPONATET, HISTORI AUTOKTONIE

Eksponatet dhe inventari arkeologjik i muzeut janë nga më të thjeshtat e deri ato të zbukuruara me figura e skalitje të ndryshme dhe me simbolika vendase që nga ajo parakristiane e Diellit e deri ato Krisatine etjerë. Muzeu me gjithë këto eksponate arkeologjike dhe etnografike që mbanë brenda me një histori autoktonie iliro-shqiptare rreth tremijë-vjeçare, të cilat të duket se të thonë:

“Fis ma t’vjeter kund nuk ka, se asht ky fis n’za i Shqiptarit, në mes t’cilit punët e mëdha, për Europë xunë t’enden sparit”.

Inventari i shumtë i eksponateve arkeologjike dhe etnografike të muzeut që e shohim na shpalos jo vetëm historinë iliro-shqiptare në përgjithsi, por mbi të gjitha, historinë e qytetimit dhe zhvillimit të dy fiseve të njohura ilire të këtyre trojeve; Labeateve dhe Diokleateve (që “ndaheshin” dhe bashkoheshin “këtu”), të dinastisë shqiptare të Balshajve e tjerë deri në ditët e sotme. Ndërsa ne banorët e këtyre trevave shqiptare, (sot disa edhe “malazeze”), me ndërjegje apo pa ndërjegje jemi trashigimtarët direkt të këtyre fiseve iliro-shqiptare, gjë të cilën e tregojnë jo vetëm shumë zakone, doke e tradita jetësore të “perbashkëta”, por edhe eksponatet arkeologjike dhe etnografike të këtij muzeu. Prej shekujsh në hisen e truallit tonë kanë mbirë edhe farëra të huaja që na kishin sjellë ndër shekuj erërat e lindjes. Ku shpesh nga keto farëra të huaja mbinë dhe u rriten bimë të harlisura (edhe me “hormonet” stimuluese të Europes plakë), sa që kerkuan të na marrin edhe hisen e diellit, tokes dhe qiellit, që na kishte falur vetë krijuesi të parëve që me krijimin e jetës mbi këto troje. Muzeu me inventarin e tij arkeologjik dhe etnografik të mbledhur dhe sistemuar nga etnografi erudit Shtjefen Ivezaj është një dëshmi monumentale e vijshmerisë historike iliro-shqiptare me kahje vetëm europiane-përendimore.

PAK FJALË NË VEND TË NJË EPILOGU

Muzeu etnografik i Malësisë (*edhe pse vetëm në disa metra katrore, në katër dhoma e një koridor*), me inventarin e tij arkeologjik dhe etnografik ruan në vetvehte rrënjë Iliro-Shqiptare të pa “thara” kurrë, edhe pse mbi trojet tona etnike vërshuan më shumë acare, rrëbeshe e stuhi se ditë të mira me diell. Ndaj themi se muzeu etnografik i Malësisë është Malësia e dëshmimeve 3000 vjeçare të rrënjëve Iliro-Shqiptare, si dhe krenaria jonë, krenari e cila më ngjason me vargjet brilante të gjermanit Dr. Gerhard Geseman me titull: “Krenari Shqiptarësh”, nga e cila zgjedha të citoj:

“E ruajta, e mbrojta, u gjakosa për këtë tokë, ndër motet ma të veshtira pushken pata shok. Në lahuten time do ta gjesh historinë, të lashtë sa rruzulli për mua, për Shqipërinë! Më ka lindë shqiptarja e ashpër e fortë, midis dhenëve dhe krismave, mbi shkambin e ftohtë, Më ka mbeshjtjellun me shallin e leshtë e të ngrohtë, pshtjellakun ma të mirë, që s’asht pa në botë! Lidhur më ka me sixhim, loze manaferre. Nuk më ka perkedhelur, por ushqye me tamel dele! Dhe për këtë jam betue: Askujt udhen për vendin e të parëve nuk kam me ja lëshue.

PËRFUNDIME

1. Referati im ka si qëllim të memorizoj sado pak risitë e këtij muzeu dhe njëkohësisht të sensibilizoj faktorin shoqëror, shkencor e shtetror shqiptar, për ruajtjen e këtij muzeu si monument kulture e historie të trojeve tona etnike, edhe pse jashtë kufijëve politik të Shqipërisë.
2. Kjo duke u bazuar në ligjet e të drejtën ndërkombëtare të ruajtjes të trashigimisë kulturore e historike të popujve të praktikuar deri tani.

3. Hollësi për muzeun dhe risitë e tij të autoktonisë gjinden në monografinë time me titull: Muzeu Etnografik i Malësisë, vepër monumentale autoktonie e Shtjefen Ivezaj-t. Muzeu gjindet në Lekaj-Tuz, Mali i Zi.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. At Shtjefen Gjeçovi, Një Argëtim Arkeologjik, botuar në vitin 1920, Ruzhdi Mata; Shtjefen Gjeçovi, Jeta dhe Vepra, fq.67, Tiranë 1982.
2. Hyacinthe Hecquard (Historia dhe pershkrimi i Shqipërisë së Eperme ose Gegërisë, fq.196, Plejad 2008.
3. Giuseppe Gelcich, Zeta dhe Dinastia e Balshajve, fq.366, sh.b.“55”, Tiranë 2009.
4. Franc Nopça, UDHETIME NËPËR BALLKAN, fq.16.sh.b. Plejad, Tiranë 2007.
5. Luigi M.Ugolini, SHQIPERIA E LASHTE , gjurmime arkeologjike, fq.34, 86-87. Sh.b. “Migjeni”, Tiranë 2009.
6. Luigi M.Ugolini, po aty, fq.70.
7. Ruzhdi Mata,po aty, Shtjefen Gjeçovi, Jeta dhe Veprat, fq.71, Tiranë 1982.
8. Skender Anamali., Arkeologjia dhe Bujqesia. fq.13-14, shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë 1980.
9. At Kolë Berishaj, Përreth sofrave, vepra-I-, fq.18-45, Misioni Françeskan Tuz, Enti Botues “Gjergj Fishta”, 2013.
10. At Kolë P. Berishaj, Sofrat në Malësinë e Madhe, fq.7, Ferizaj 1990.
11. At Anton Harapi , Andrra e Pretashit ,fq.154 , botime Franceskane , Shkoder 2008.
12. At Gjergj Fishta, Furka, rev. Grueja Shqyptare, nr.3, viti 1921.
13. Skender Anamali., Arkeologjia dhe Bujqesia..fq.105-110.
14. At Shtjefën Gjeçovi Agimi i gjytetnisë, -1910, fq.114-115, botime Françeskane, Shkodër 2018.
15. Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, perg. Nga Selim Islami (red.pergjegjës), Frano Prendi, Hasan Ceka, Skender Anamali, fq.360, botime Toena, Tiranë 2002.
16. Skender Anamali, po aty, fq.26-27.
17. At Kolë P. Berishaj, Etnografi -3-, fq.46-48, Enti botues poligrafik “At Gjergj Fishta”, Tiranë 2003.
18. John Foster Fraser, ”Shqipëria e Poshtme”, fq.11, botimi shqip : Zenit Editions 2009.
19. At Gjergj Fishta ; Vallja e Parrizit, Mrizi i Zanave,Anzat e Parnasit, fq.9, enti botues Lisitan, Lezhë 1994.
20. Sulejman Krasniqi, ”Oso Kuka”..,fq.247-248. sh.botuese “Naim Frashri”,Tiranë 1990, Prof. dr. Andromaqi Gjergji ; Xhubleta një element i lashtë kulturor, Matriale të sesionit shkencor, Malesia e Madhe një visar shqiptarie , fq.116, Koplik, dt.23-24 shtator 1996, botim “Logoreci” Tiranë 1997.
21. Aleksander Stipçeviq, ILIRET, historia, jeta, kultura, simbolet e kombit fq.91, botime Toena, Tiranë 2002.
22. Aleksander Stipçeviq, po aty, fq.92.
23. Lovro Mihaçeviq, Njëpër Shqiperi 1883-1907, mbresa udhetime e etnografi, fq.119, Enti botues “Gjergj Fishta”, 2006.
24. At Kolë P. Berishaj, Etnografi -3-, fq.56-59, Enti botues poligrafik “At Gjergj Fishta”, Tiranë 2003.
25. Lovro Mihaçeviq, Nepr Shqiperi-1883-1907,fq.130.
26. John Foster Fraser, po aty, fq.8.
27. Aleksander Stipçeviq, po aty, fq.89.
28. At Gj.Fishta, Hyrja te “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, mbledhur nga Shtjefen Gjeçovi.

- 29.** Iliret dhe Iliria te Autoret Antik, fq.155.
- 30.** At Gjon Karma, Folklorë, Përmbledhje vrojtimesh përmbi zakonet edhe Giuhen popullore të botueme në rivisten “Leka”ndër 11 vjetët e para, Kerkime ndër malet e Veriut, fq.261, riprodhim i përpiktë i orgjinalit, shtypur në shtypshkronjën “Shkodra”, Shkodër 2002.
- 31.** Botim special i rev. “Leka”me me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqiperisë, 1937 , fq.29(631).
- 32.** At Gjergj Fishta, Lahuta e Malesisë, fq.105, Romë 1991.
- 33.** Sulejman Krasniqi, Oso Kuka, fq.140, sh.botuese “Naim Frashri”, Tiranë 1990.